



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË

Buxheti

Viti 2025

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë gjatë vitit buxhetor 2025 është angazhuar në realizimin e planit duke u mbështetur plotësisht në burimet e tij, duke garantuar pavarësinë ekonomike të institucionit. Gjatë kësaj periudhe UISH ka patur bashkëpunim shumë të mirë me institucionet publike dhe private, veçanërisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe me urdhrat profesionalë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor dhe zhvillimeve në sektor.

A.-Realizimi i të ardhurave për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, shihet një rritje e ndjeshme e realizimit të të ardhurave krahasuar me vitin paraardhës.

Kjo lidhet me numrin e aplikimeve nga:

- Kuotat e anëtarësisë,
- Lejet e reja për ushtrim profesioni,
- Rinovime për leje ushtrim profesioni,
- Kryerja e praktikës profesionale,
- Të ardhura të tjera

Nr	Emërtimi	Plani 2025	Realizimi 2025	%
I.	Të ardhurat gjithsej	82,000,000	81,858,515	99.8
1.	Nga kuotat e antarësisë	35,000,000	30,509,403	87
2.	Nga lejet e reja, për ushtrim profesioni	12,000,000	6,566,040	55
3.	Rinovim për leje të ushtrimit të profesionit	20,000,000	24,109,615	121
4.	Nga kryeria e praktikës profesionale (dosjet)	8,000,000	13,331,787	167
5.	Të ardhura të tjera	7,000,000	7,341,670	105

Për vitin 2025 të ardhurat nga **82,000,000** lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën **81,858,515** lekë ose **99.8 %** e planit. Ndërsa shpenzimet operative me ndryshimet përkatëse të rritjes së pagave dhe të honorareve nga **81,985,107** lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën **76,012,263** lekë ose **93 %** e planit.

Për sa më lart, vlen të theksohet të ardhurat nga rilicencimet janë 121 % si dhe të ardhurat nga kryerja e praktikës në 167 % , të cilat janë rrjedhojë e nga aplikimeve për rinovime të licensave, si dhe nga rritja e numrit të praktikantëve.

Gjatë këtij viti buxhetor rezulton një ulje të të ardhurave nga kuotat, duke u realizuar faktikisht 87 % e tyre nga plani.

B. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2025

Kategoria	Plani	Realizimi	%
Shpenzime	81,985,107	76,012,263	93%
Investime (ndërtim, pajisje zyre)	16,000,000	13,093,949	82%
Totali	97,985,107	89,106,212	91%

Realizimi i shpenzimeve është kryer në përputhje me prioritetet e institucionit dhe në funksion të administrimit të kujdesshëm të fondeve.

Shpenzimet operative janë përqendruar në përmbushjen e detyrimeve kryesore, ndërsa investimet janë realizuar pjesërisht, në përputhje me ecurinë e projekteve të planifikuara.

Në përgjithësi, treguesit financiarë për vitin 2025 dëshmojnë për një menaxhim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të burimeve, në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale.

DREJTORI BURIMEVE NJEREZORE DHE I FINANCES

Xhevdet USHE